



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.69/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Faton Ademi kryesues, Afijete Sada Gillogjani dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Besmir Fetoshi nga Austria, kundër vendimit të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 22.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si i parregullt apeli Anr.69/2019. i datës 22.09.2019, parashtruar nga Besmir Fetoshi nga Austria me të cilin ka kërkuar që të përfshihet në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 20.09.2019, PZAP-i ka pranuar një apel nga Besmir Fetoshi nga Austria, i cili apelit të tij i ka bashkangjitur keto dokumente si pretendime të tij: kopjen e leternjoftimit, kofirmimin për pranim të aplikacionit nga KQZ, dhe formularin e aplikimit për votim jashtë Kosoves .

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimit e apelimt, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i parregullt

Paneli i PZAP-it, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i parashtruar nga ana e Besmir Fetoshit është i parregullt, dhe si i tillë apeli nuk i plotëson standartet e kërkuara sipas Rregullës Nr.02/2015, nenit 11.5 ku përcaktohet se: Apelet të cilat janë të palejuara dhe të pasafatshme PZAP-i i i hudhë poshtë me vendim.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kriteret e kërkuara ligjore nga dispozita e cekur më lartë.

Nga arsyet e sipërshënuara e në mbështetje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Nr.02/2015) dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa

Anr. 69/2019 më datën 22.09.2019

Kryesues i Panelit

Faton Ademi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në *Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*

